

“TRENDI I EUROSKEPTICIZMIT NË SHQIPËRI, MAQEDONINË E VERIUT DHE NË  
KOSOVË. VËSHTRIM KRAHASUES MES KËTYRE VENDEVE.”

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SHKENCËS NË INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE



EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

nga

ARBENITA DEMAKU

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

Prishtinë, shtator, 2022

‘Trendi i Euroskepticizmit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë. Vështrim krahasues mes këtyre vendeve‘

Nga  
Arbenita Demaku

Mentori: Prof. Ass.Dr Bardhok Bashota,

Ky punim diplome shqyrton trendin e euroskepticizmit në vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë) në kushtet në të cilat u ndodh Bashkimi Evropian, me kapacitete të kufizuara për të investuar në zgjerimin e mëtejshëm, nga e ashtuquajtura "lodhje nga zgjerimi", pastaj edhe rritja e zërave euroskeptik në vetë BE-në, duket se ka dëmtuar rëndë besueshmërinë e perspektivës së zgjerimit të Ballkanit Perëndimor, duke shkaktuar zgjatjen e procesit të pranimit të Ballkanit. Kjo zgjatja e këtij procesi përmes kriterëve shtesë për t'i përmbushur, politika kushtëzuese e përdorur dhe mos përmbushja e shumë premtimeve karshi Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut siç duket ka zbehur besueshmërinë në BE dhe trendi i euroskepticizmin ka shkuar duke u rritur duke shkaktuar një lodhje në vetë Ballkanit Perëndimor ndaj BE-së. Ky punim shqyrton pikëpamjet e brendshme për Evropën, duke argumentuar se vendet e reja anëtare aspiruese të BE-së kanë qenë duke përjetuar forma të ndryshme të euroskepticizmit për shkak të një numri të faktorëve socio-ekonomikë, kulturorë dhe politikë.. Megjithatë, siç argumenton ky punim, euroskepticizmi në kontekstin e Ballkanit Perëndimor nuk është një refuzim i perspektivës evropiane dhe kërkimi i alternativave tjera, por më tepër një kritikë rreth metodave, kohës dhe ndikimi i procesit të integritimit.

## **PËRBËRJA/ARKITEKTURA E PUNIMIT**

Në rrafshin strukturor, ky studim është organizuar në pesë kapituj dhe titujt brenda tyre.

Para se të filloj me kapitujt kam bërë një pasqyrë hyrëse të studimit, qëllimin e punimit, kam treguar për metodologjinë e përdorur gjatë punimit, hipotezat e studimit si dhe pyetjen hulumtuese.

***Në kapitullin e parë*** fillimisht janë paraqitur vështrimet gjenealogjike të zgjerimit të Bashkimit evropian duke paraqitur teoritë e integriteteve evropiane, vështrim i shkurtër gjenealogjik i zgjerimit të BE-së duke paraqitur etapat e zgjerimit të BE-së në vazhdimësi, pastaj duke shtjelluar procesin e zgjerimit në aspektin e hapave të ndërmarre në shtrirjen e BE-së nga përcaktimi deri në pjesën jug-lindore. Në fund të këtij kapitulli kam paraqitur edhe konteksti gjeopolitik i orientimit të BE-së drejt Evropës juglindore.

***Në kapitullin e dytë*** kam diskutuar procesin e zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor, duke shqyrtuar në veçanti hapjen e perspektives Evropiane për shtetet e Ballkanit Perëndimor, pastaj do ndalemi tek Procesi i Stabilizim-Asociimit si kornizë gjithëpërfshirëse për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe i gjithë prezantimi në këtë kapitull do diskutojmë edhe Instrumentet të Procesit të Stabilizim-Asociimit ndaj Ballkanit Perëndimor, si MSA e cila është marrëveshje kontraktuale mes BE-së dhe shtetit i cili ka perspektivë evropiane.

***Në kapitullin e tretë*** pas shtjellimeve paraprakë të lodhjes nga zgjerimi brenda BE-së do të shtjellojmë konkretisht tek kapitulli i tretë rreth stagnimit të procesit të anëtarësimit konkretisht arsyeve së pse ka stagnuar procesi i zgjerimit, do elaborojmë ndikimin që ka pasur BREXIT-it për rikthim të vëmendjes së BE-së në çështje të brendshme, pastaj edhe efektin që ka pasur rritja e forcave euro-skeptike në forcimin e kriterëve për anëtarësim për BP-në.

Ndërsa në pjesën e fundin të këtij kapitulli kam paraqitur si ka ndikuar kriza me emigrantë ilegal në rënien e interesimit për zgjerim të mëtejshëm për t'u marrur më punët e brendshme dhe jo-serioziteti i vendeve të Ballkanit në përmbushja kualitative të kriterëve për anëtarësim.

***Në kapitullin e katërt*** kam shtjelluar trendin aktual i euroskepticizmit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë në kushtet e euro-skepticizmit që janë prezent brenda këtyre shteteve. Kam paraqitur shkaqet që kanë ndikuar në shfaqjen e euroskepticizmit, në secilin nga këto tri vendet dhe do të tentojmë t'i paraqesim disa të dhëna statistikore rreth trendit të euroskepticizmit në secilin vend.

***Ndërsa në kapitullin e pestë*** kam analizuar situatën aktuale e orientimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor në kushtet e krizës në Ukrainë dhe se sa i ka kushtuar rëndësi BE-ja BP-së dhe qasja e saj ndaj aspiratave të tyre integruese në BE.

## **HIPOTEZA DHE PYTJE HULUMTUESE**

**H.1:** *“Bashkimi Evropian ka mekanizma efektiv për pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor”*

**H.2:** *“Zhvillimet e brendshme politike në BE kanë quar në rënien e interesimit për prioritizimin e zgjerim të mëtejshëm”*

**H.3:** *“Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Kosova nuk kanë arritur ti përmbushin obligimet e anëtarësimit në dinamika reale”*

**H.4:** *“Në Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Kosovë ka një trend të rritjes së euroskepticizmit në mesin e elitës politike dhe qytetarëve.”*

Përveç hipotezave të punimit të paraqitura më lartë, dhe më qëllim të arritjes sa më të saktë të rezultateve gjatë hulumtimit, kemi paraqitur edhe pyetjet hulumtuese:

**Pyetja 1:** *A është rritur euroskepticizmi në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë?*

**Pyetja 2:** *Cilat janë shkaqet që qe kanë dërguar në rritjen euroskepticizmit në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë?*

**Pyetja 3:** *A ka pasur ndikim dalja e Britanisë së Madhe nga BE në procesin e integritit të Ballkanit Perëndimor?*